



**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA
ZYRA E AUDITORIT PERGJITHSHEM/KANCELARIJA GENERALNOG
REVIZORA/OFFICE OF THE AUDITOR GENERAL**

Nr. dokumentit. 21.0.1-2008-08

**RAPORTI I AUDITIMIT TË PASQYRAVE FINANCIARE
TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS
PËR FUND VITIN 31 DHJETOR 2008**

Prishtinë, Korrik 2009

Tabela e përmbajtjes

- I. Përmbledhje e përgjithshme
- II. Hyrje
- III. Gjendja lidhur me rekomandimet nga viti i kaluar
- IV. Fushëveprimi i auditimit
- V. Qasja e auditimit
- VI. Opinioni i auditimit
- VII. Të gjeturat dhe rekomandimet kryesore të auditimit

Shtojcat:

- I. Llojet e ndryshme të Opinioneve të Auditimit (ISSAI 400)
- II. Komentet e Kuvendit të Kosovës-së dhe Përgjigja e ZAP-it

Lista e shkurtesave

AP	Auditori Përgjithshëm
APP	Agjensioni i Prokurimit Publik
BQK	Banka Qendrore e Kosovës
BKK	Buxheti i Konsoliduar i Kosovës
ICO	Zyra Civile Ndërkombëtare
LMFPP	Ligji Nr. 03/L-048 Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë
LPP	Ligji Nr. 2003/17 Për Prokurimin Publik në Kosovë Me ndryshimet dhe plotësimet e datës 8 shkurt 2007
FNK	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
KRK	Kuvendi i Republikës së Kosovës
PSSP	Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare Institucioneve Supreme të Auditimit
INTOSAI	Organizatat Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
SNKSP	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
SIMFK	Sistemi Informativ i Menaxhimit Financiar të Kosovës
ZAP	Zyra e Auditorit të Përgjithshëm

I. Përmbledhje e përgjithshme

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP), ka kryer auditimin e Pasqyrave Financiare të Kuvendit të Republikës së Kosovës (KRRK) për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2008.

Auditimi ynë është kryer, në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit të hartuara, nga INTOSAI dhe ka përfshirë testet dhe procedurat që në menduam se ishin të nevojshme, për të dhënë një opinion lidhur me pasqyrat financiare.

Për mendimin tonë, *pasqyrat financiare paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë*, në të gjitha aspektet materiale.

Si theksim i çështjeve të dala nga rezultatet e punës sonë audituese janë:

Regjistri i pasurive fikse ende nuk është i besueshëm, dhe mosparaqitja e të gjitha obligimeve në pasqyra financiare. Ai duhet të përpilohet në pajtim me Udhëzimin Administrativ nr. 2005/11, Regjistrimi dhe menaxhimi i pasurive qeveritare. (ISSAI 400 Opinion i pakualifikuar me theksim të çështjeve).

Auditimi ynë ka shpalosur disa dobësi që kanë të bëjnë me ekzekutimin e buxhetit dhe sistemin e kontrollit të brendshëm

1. Kuvendi i Kosovës nuk e ka bërë shpalosjen e të gjitha pasurive në pasqyrat financiare
2. Pasqyrat financiare i kanë përgatitur në baze të shënimeve të thesarit.
3. Sistemi i kontrollit të brendshëm nuk ka funksionuar në nivelin e duhur.
4. Mungon kontrolla e mjaftueshme funksionale mbi menaxhimin dhe ekzekutimin e procedurave të prokurimit.
5. Menaxhim joefikas në shpenzimin e reprezentacionit
6. Nuk ka kontroll të mjaftueshme dhe menaxhim funksional mbi shfrytëzimin e pasurisë
7. Nuk janë prezantuar të gjitha obligimet në pasqyra financiare
8. Mos mbyllja e avancit për periudhë shumë të gjata, tregon për mungesë të menaxhimit serioz.

Ne kemi dhënë rekomandimet që ne besojmë se do t'i ndihmojnë menaxhmentit për t'i drejtuar këto dobësi dhe ta përmirësojë më tutje efikasitetin e menaxhimit të mjeteve publike

II. Hyrje

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm sipas ligjit është përgjegjëse për kryerjen e auditimeve vjetore të rregullsisë.

Auditimi i Rregullsisë është definuar si verifikim i kontabilitetit financiar, duke përfshirë ekzaminimin dhe vlerësimin e deklaratave financiare dhe të dhënave tjera financiare si dhe dhënien e mendimeve:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm;
- Për ndershmërinë dhe drejtësinë e vendimeve administrative që merren nga institucioni ose subjekti që i është nënshtruar auditimit; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin;

Është përgjegjësi e Kuvendit të Republikës së Kosovës që ti përgatisë pasqyrat financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNKSP), për “Raportimin financiar në bazë të kontabilitetit të parasë së gatshme”, në përputhje me Udhëzimin Administrativ 2008/13, dhe ato ti prezantoj me kohë.

III. Gjendja lidhur me rekomandimet nga viti i kaluar

Raporti ynë i auditimit të Pasqyrave Financiare të vitit 2007 kishte dhënë 7 rekomandime. Nga këto, 4 janë implementuar ndërsa të tjerat mbeten të implementohen. Ato më të rëndësishmet janë

- a) Rekomandimi për blerjen e një programi përkatës të kontabilitetit për regjistrimin e të gjitha të dhënave financiare, në mënyre që kontrolla e brendshme të jete sa më efektive dhe funksionale.
- b) Rekomandim mbi specifikimin e mallrave në mënyre të plote në urdhërblerja më të cilat Kuvendi i Republikës së Kosovës do të furnizohet.
- c) Rekomandim mbi mbylljen e avancave që shumat e pashpenzuara duhet të kthehen dhe këto mjete të derdhen në BKK.
- d) Rekomandim për mos vlerësimin dhe kompletimin e pasurisë.

IV. Fushëveprimi i auditimit

Ky auditim i Kuvendit të Kosovës ka të bëjë me pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2008.

Objektivë primare e këtij auditimi është që t'i mundësohet ZAP-së të shprehë opinionin e saj nëse pasqyrat financiare të Kuvendit të Kosovës japin një pasqyrë të vërtet dhe të drejtë dhe nëse regjistrat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me Ligjet dhe rregulloret aplikative.

V. Qasja e auditimit

Auditimi ynë ishte planifikuar dhe realizuar gjatë periudhës prej 25 maj 2009 deri me 19 Qershor 2009 në bazë të Standardeve të Auditimit të INTOSAI-it.

Me qëllim të përmbushjes së përgjegjësive tona, ne:

1. Kemi rishikuar pasqyrat financiare të Kuvendit të Kosovës në raport me buxhetin e miratuar për vitin 2008;
2. Kemi përcaktuar nëse pasqyrat financiare të Kuvendit të Kosovës janë përgatitur në pajtim me SNKSP-të “ Raportimi Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme”;
3. Kemi kryer teste substanciale gjithëpërfshirëse mbi transaksionet financiare;
4. Kemi zbatuar një kombinim të mostrimit sipas gjykimit dhe sipas rastit, në përzgjedhjen e transaksioneve për testim;
5. Kemi përcaktuar nivelet e materialitetit, 5% për paqartësitë dhe 3% për gabimet, si prag për lehtësimin e përcaktimit të llojit të opinionit që duhet dhënë mbi pasqyrat financiare;
6. Jemi mbështetur në një lloj kombinimi të intervistave, rishikimeve analitike, rishikimin e dokumenteve dhe verifikimin fizik për të vlerësuar vlefshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve financiare;
7. Kemi vlerësuar pavarësinë dhe cilësinë e punës së Njesisë së Auditimit të Brendshëm në kuadër të Kuvendi i Kosovës, për të përcaktuar nëse mund të mbështetemi në punën e tyre për qëllimet e auditimit tonë ;

Të gjeturat dhe konkluzionet tona të auditimit bazohen në dokumentacionin dhe informatat e tjera të cilat na janë dhënë gjatë punës sonë të auditimit.

Lidhur me opinionin tonë të auditimit për pasqyrat financiare të Kuvendi i Kosovës, standardet ndërkombëtare përcaktojnë kriteret specifike të cilat rregullojnë llojin e opinionit i cili mund të jepet. Opinioni i auditimit mund të jetë i pakualifikuar, i kualifikuar, i kundërt ose mund të jetë edhe mohim i opinionit (Cf. Aneksi 1 ISSAI 400).

VI. Opinioni i auditimit

Për mendimin tonë, *pasqyrat financiare paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë*, në të gjitha aspektet materiale.

Si theksim i çështjeve të dala nga rezultatet e punës sonë audituese janë: Regjistri i pasurive fikse ende nuk është i besueshëm, dhe mosparaqitja e të gjitha obligimeve në pasqyra financiare. Ai duhet të përpilohet në pajtim me Udhëzimin Administrativ nr. 2005/11, Regjistrimi dhe menaxhimi i pasurive qeveritare. (ISSAI 400 Opinion i pakualifikuar me theksim të çështjeve). (ISSAI 400 Opinion i pakualifikuar).

VII. Të gjeturat dhe rekomandimet kryesore të auditimit

1. Rezultati Financiar në krahasim me Buxhetin e Aprovuar

Analizën e rezultatit në Pasqyrat Financiare kundrejt Buxhetit të Aprovuar për kategoritë e shpenzimeve i kemi paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Tabela 1: Buxheti

Nr.	Pagesat nga buxheti	Buxheti i aprovuar në €	Buxheti i shpenzuar në €	në %
1.	Pagat	4,114,346	4,063,063	98
2.	Mallrat dhe shërbimet	1,168,160	1,134,361	97
3.	Shpenzimet komunale	162,743	150,091	92
4.	Subvencionet	1,913,783	1,903,577	99
5.	Investimet Kapitale	1,477,500	420,027	28
6.	Gjithsej:	8,836,532	7,671,118	86

Shpenzimet e përgjithshme aktuale të paguara për vitin 2008 sipas pasqyrave financiare ishin 7,671,118 €, si obligime të papaguara të prezantuara në pasqyra financiare për vitin 2008 kane qene 2,162 € të bartura për t'u paguar në vitin 2009.

Në baze të testimeve të kryera konstatojmë se Kuvendi i Kosovës nuk i ka prezantuar në pasqyra financiare si obligime të papaguara për vitin 2008 edhe 14,063 € .

Krahasuar me buxhetin për 2008 Kuvendi kishte shpenzuar rreth 86 % të buxhetit të planifikuar dhe në fund të vitit 2008 kishte një deficit prej 1,165,417.€

Shpenzimet kapitale sipas pasqyrave financiare të Kuvendi i Kosovës nuk janë realizuar në baze të planifikimi të kryer, ku ekziston një mosrealizim i shumës së buxhetuar në vlerë prej 1,057,473 € ose vetëm 28.42 %.

Konkluzioni

Shkalla e shfrytëzimit të buxhetit të alokuar për nevojat e aktiviteteteve operative të Kuvendit të Kosovës nuk mund të konsiderohet e kënaqshme. Teprica e buxhetit në fund të vitit prej 14% është një indikacion se; ose ishte planifikimi jo i duhur i nevojave buxhetore ose departamentet përkatëse nuk kishin përmbushur objektivat e përcaktuara. .

Rekomandim 1:

Rekomandojmë Sekretarin permanent të Kuvendit të Kosovës :

- 1.1 Për çdo planifikim buxhetor duhet të bëhen analiza detale sipas linjave buxhetore dhe vlerave konkrete në mënyre që shpenzimet buxhetore të jenë në pajtim me planifikimin real buxhetor. Planifikimi për nevojat buxhetore duhet përmirësohet, gjithashtu edhe monitorimi.

2. Pasqyrat Financiare

Pasqyrat financiare të vitit 2008 janë të sakta dhe të prezantuara drejt në aspektin material dhe në pajtim me UA 2008/13 të MEF-it “Raportimi vjetor i organizatave buxhetore”. përveç disa shpalosjeve të disa shumave të pasqyrave financiare që është dashur të shpalosen për të qenë më të kuptueshme për lexuesin.

Shumat që është dashur të shpalosen në pasqyra financiare në pjesën “raporti i pranimeve dhe programeve” janë disa nga këta zëra:

- 2.1 Në pasqyra financiare nuk janë të paraqitura te gjitha pasurit e blera apo investuara gjate vitit 2008.

- 2.2 Në pasqyrat financiare të vitit 2008, Kuvendi i Kosovës nuk i ka prezantuar si obligime financiare rreth 14,063 € të cilat kane mbetur të paguhen në vitin 2009.

Konkluzioni

Pasqyrat financiare janë përgatitur duke u bazuar në UA 2008/13 të MEF-it “Raportimi vjetor i organizatave buxhetore”, por nuk janë bërë shpalosjet e detajuara të shënimeve të pasqyrave financiare siç kërkohet me nenin 12 të këtij udhëzimi.

Rekomandimi 2:

Rekomandohet Sekretarin permanent të Kuvendit të Kosovës:

Që Pasqyrat financiare të përgatiten në harmoni me UA të MEF-it “Raportimi vjetor i organizatave buxhetore” dhe shumat nga burimet e ndryshme të prezantohen në pozicione të veçanta ose të shpalosen dhe të sqarohen me informata më të zgjeruara .

3. Realizimi i buxhetit

3.1 Paga, mëditje dhe dosja e personelit

Gjate vitit 2008 për kategorinë e pagave dhe mëditje janë buxhetuar në vlerën prej 4,114,346 € ndërsa janë shpenzuar 4,063,063 € ose 98.75 %.

Kemi bërë testimin e pagave dhe krahasimin e tyre në mes listave të Kuvendit të Kosovës dhe listave të payrollit si dhe kemi përzgjedhur një mostër prej 14 regjistrash nga dosjet e personelit të Administratës Qendrore, e cila mbahet nga zyra e personelit të Kuvendit të Kosovës. Nga procedurat e aplikuara për auditim, ne nuk kemi hasur në ndonjë paqartësi të theksuar ne menaxhimin e pagave dhe shfrytëzimin e tyre.

Rasti i vetëm i përshkruar me parregullsi është tek rekrutimi i Udhëheqësit të prokurimit. i cili është përzgjedhur për një periudhe 5 mujore pa procedura rekrutuese.

Konkluzioni:

Nuk është respektuar Udhëzimi Administrativ Nr. MSHP/DASHC 2003/01 “Procedurat e rekrutimit” për zbatimin e UA 2003/2 zbatimi i Rregullores se UNMIK-ut nr. 2001/36 për Shërbimin Civil të Kosovës.

Rekomandim 3:

Rekomandojmë Sekretarin permanent të Kuvendit të Kosovës :

3.1 Duhet ti aplikoj te gjitha procedurat e rekrutimit në pajtueshmëri të plotë me nenin 2,3 dhe nenin 5 pika d të Udhëzimit Administrativ nr.MSHP/DASHC 2003/1 Procedurat e Rekrutimit, për zbatimin e Urdhëresës Administrative nr. 2003/2 zbatimi i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/36 për Shërbimin Civil të Kosovës.

3.2 Shpenzimet përmes procedurave të prokurimit

Ligji nr. 2003/17 mbi Prokurimin Publik i përcakton kërkesat ligjore të cilat duhet të respektohen për shfrytëzimin e mjeteve publike gjatë aktivitetit të prokurimit. Parimet e përgjithshme të LPP-së thërrasin në ekonomizim, efikasitet, barabarësi dhe drejtësi për të gjitha kontratat e prokurimit.

Të gjeturat:

Në fushën e prokurimit kemi identifikuar disa raste ku procedurat e prokurimit, nuk janë në harmoni me kërkesat e Ligjit mbi Prokurim Publik të Kosovës Nr. 2003/17.

Në vijim i paraqesim këto raste të identifikuar

- Zyra e Prokurimit, nuk e ka përgatitur planin preliminar dhe përfundimtar për vitin 2008.
- Për disa prokurime nuk ka ekzistuar deklarata e nevojave dhe disponueshmërisë së mjeteve.
- Mosekzekutimi i punëve dhe shërbimeve të kryera sipas planit të liferimit
- Për blerje të 10 llaptopave mungon kërkesa dhe arsyeshmeria e blerjes së tyre.
- Mos aplikimi i penaleve (ndëshkimeve) nga Kuvendi i Kosovës për vonesat në ekzekutimin e punëve ndaj operatoreve ekonomik.
- Mosekzekutimi i disa pagesave sipas kontratës për punët e kryera ndaj operatoreve ekonomik
- Vonasat në formimin e komisioneve për pranimit teknik për punët e përfunduara

3.2.1 Mos përgatitja e planit përfundimtar të prokurimit

Zyra e prokurimit nuk e ka përgatitur planin përfundimtar të prokurimit për vitin 2008, çka është në kundërshtim me nenin 7.2 të Ligjit të Prokurimit Publik nr. 2003/17, ku brenda 15 ditëve kalendarike pas shpalljes së legjislacionit mbi përvetësimet për një vit fiskal, çdo autoritet kontraktues do të përgatisë dhe do të dorëzojë APP-se, një planifikim përfundimtar me shkrim që i identifikon të gjitha furnizimet, shërbimet dhe punët që autoriteti kontraktues synon të prokurorë gjatë vitit fiskal.

3.2.2 Mungesa e deklaratës së nevojave dhe disponueshmërisë së mjeteve

Ka munguar për tri prokurime të kryera:

- Furnizim me llaptop me nr, kontratës 08-036-121 në vlerë prej 55,556 €; ku janë blerë 82 llaptop për 10 llaptop nuk ka patur kërkesë të aprovuar.
- Renovimi i sallës 302 me nr, kontratës 08-075-521 në vlerë prej 22,342 €; dhe
- Renovimi i kulmit dhe terracave me nr, kontratës 08-077-521 në vlerën prej 139,900 € nuk është përgatitur deklarata e nevojave dhe disponueshmërisë së mjeteve çka është në kundërshtim me nenin 8.1 të Ligjit të Prokurimit publik nr, 2003/17 ku thuhet se para çdo fillimi të çdo aktiviteti ose procedure të veçante të prokurimit që ka për qëllim blerjen e çdo produkti, shërbimi ose pune, autoriteti kontraktues duhet të bëjë një vlerësim formal të nevojave lidhur me këto.

3.2.3 Mos njoftimi i kompanive ofertuese për eliminimin e tyre

Për tre prokurime të kryera

- Furnizimi me llaptop, me nr, kontratës 08-036-121 në vlerë prej 55,556 € ;
 - Renovimi i sallës 302 me nr, kontratës 08-075-521 në vlerë prej 22,342 € dhe
 - Material shpenzues për zyre me nr, kontratës 08-074-121 në vlerë prej 19,550 €
- nuk është bërë njoftimi për kompanitë e eliminuar nga procedurat tenderuese, ku sipas nenit 52.1 të Ligjit të Prokurimit Publik, kur një autoritet kontraktues e eliminon një tenderues nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit, autoriteti i tillë kontraktues duhet që menjëherë të njoftoj kandidatin ose tenderuesin me shkrim mbi këtë fakt.

3.2.4 Mosekzekutimi i punëve dhe shërbimeve të kryera sipas planit të liferimit

Tri prokurimet e mëposhtme nuk janë kryer sipas afatit të kontraktuar:

- Furnizim, montimi i trafostacionit me nr, kontratës 07-150-121 në vlerë prej 98,379 €.
 - Renovimi i sallës 302 me nr, kontratës 08-075-521 në vlerë prej 22,342 € dhe
 - Furnizim me llaptop me nr, kontratës 08-036-121 në vlerë prej 55,555 €
- nuk janë kryer punët sipas planit të liferimit (dinamik), ku sipas nenit 7 të kontratës për çdo ditë vonesë duhet të aplikohet 0.1 % të vlerës së kontratës.

3.2.5 Moskryerja e pagesave ndaj kontraktorëve sipas kushteve të përcaktuara në kontratë

- Në renovimin e restorantit në Kuvend, punëdhënësi nuk i ka ekzekutuar pagesat ndaj punëkryerit sipas kushteve të përcaktuara në kontratë. Përveç avansit prej 20%, punëkryerit nuk i është bërë asnjë pagesë tjetër mbi ekzekutimin e punëve të kryera ku sipas nenit 12.1 të kontratës pagesat duhet të lëshohen pas pranimin të përkohshëm të punëve të kryera në vlerën 30% të vlerës së kontratës si dhe 50 % pas përmbushjes së kontratës. Punëkryerësi me datën 26.03.2009 ka kërkuar që të bëjë pranimin teknik të realizimit të kontratës, mirëpo formimi i komisionit nga Kuvendi i Kosovës për pranim teknik është bërë me datë 25.05.2009. Sipas nenit 28.2 të kontratës punëdhënësi duhet t'i paguaj kontraktuesit shumën e vërtetuar nga menaxheri i projektit brenda 28 ditësh nga data e vërtetimit të cilësisë.

- Tek furnizimi me llaptop, pranimi i mallrave është bërë me datën 11.09.2008 ndërsa pagesa është kryer me datën 03.12.2008, me vonesë prej 83 ditëve kalendarike, ku sipas nenit 26.1 të kontratës punëdhënësi duhet të ekzekutojë pagesat ndaj furnizuesit brenda 30 ditëve kalendarike me rastin e pranimin të mallrave dhe të faturës.

- Kërkesa për pranimin teknik nga kompania në ndërrimin e xhamave të fasadës është bërë me datën 27.03.2008, ndërsa pagesa është kryer me datë 03.09.2008, për afërsisht 150 ditë vonesë, që është në kundërshtim me nenin 27.2 dhe 27.3 të kontratës ku punëdhënësi do të paguaj shumën e vërtetuar nga menaxheri i projektit brenda 28 ditësh nga data e vërtetimit të cilësisë, dhe në rast të vonesës punëdhënësi duhet të paguaj kamat kompanisë për pagesat e lëshuara me vonesë.

Konkluzioni

Mosrespektimi në tërësi i procedurave të Ligjit të prokurimit dhe mosfunktionimi i kontrolles së brendshme për shpenzimin e parëse publike ndikojnë në rritjen e rreziqeve për shpërdorimin, keqpërdorimin dhe humbjen e mjeteve publike.

Rekomandim 4:

Rekomandojmë Sekretarin permanent të Kuvendit të Kosovës :

- Të përgatit dhe dorëzoj planin përfundimtar të prokurimit në APP.
- Para çdo aktiviteti të prokurimit të siguroj fonde të mjaftueshme për zbatimin e atyre projekteve, në mënyre që Kuvendi i Kosovës ti kryej detyrimet e saj ndaj operatoreve ekonomik në afatin kohor.
- Që të sigurohet transparencë adekuate ndaj operatoreve ofertues Kuvendi i Kosovës duhet që në baze të LPP-se të njoftoj me shkrim çdo operator ekonomik për eliminimin e tyre nga pjesëmarrja e mëtutjeshme tenderuese.
- Të specifikohen në mënyre të plote në urdhërblërje mallrat me të cilat Kuvendi i Kosovës parasheh të furnizohet.
- Të aplikoj procedurat adekuate për të siguruar që faturat të pranohen pas dërgimit të urdhërblërjes tek operatori ekonomik.

3.3 Shpenzimet e byfesë, reprezentacionit

Gjate vitit 2008 sipas raportit të Kuvendit të Kosovës për furnizime të byfesë janë shpenzuar në vlerën 46,739 €, i cili furnizim është kryer në baze të nevojave të kohëpaskohëshme, nga personeli i Kuvendit të Kosovës..

- Gjate vitit 2008 si shpenzime të reprezentacionit janë tejkualuar në vlerën 5,719 €, çka është në kundërshtime me pikën 6, 8 dhe 10 për përdorimin e shfrytëzimit të reprezentacionit, (shërbimeve të byfesë).
- Kuvendi i Kosovës të gjitha furnizimet për Byfe i ka kryer në baze të kërkesës së udhëheqësit të byfesë dhe furnizimet janë kryer nga kompani të ndryshme.

Konkluzioni

Kuvendi i Kosovës nuk ka vepruar në pajtim me 6 pika 8 dhe 10 rregullores së Kuvendit të Kosovës mbi shfrytëzimin e reprezentacionit (shërbimeve të byfesë) nga personat zyrtar të saj, që ndikon në rritjen e rrezikut për keqpërdorim dhe shpenzim joadekuat të parasë publike.

Rekomandim 5:

Rekomandojmë Sekretarin permanent të Kuvendit të Kosovës :

- Të krijoj monitorim efikas mbi zbatimin në tërësi të rregullores së Kuvendit mbi menaxhim dhe shfrytëzimin e reprezentacionit nga personat zyrtar të saj.

3.4 Avancet për udhëtime zyrtare

Gjatë vitit 2008, në emër të avancave për udhëtime zyrtare Kuvendi i Kosovës ka shpenzuar 206,445 €, ndërsa në kemi bërë testimin e 6 mostrave në vlerë prej 40,171 € për të analizuar shfrytëzimin dhe menaxhimin e tyre.

Nga rastet ë rishikuara kemi gjetur se tek shpenzimet për udhëtimin zyrtar në Bullgari në vlerën prej 5,255.2 € me date 29.09.2008, nuk është bërë mbyllja sipas afatit të paraparë. Në nuk kemi arritur të kuptojmë datën e mbylljes së këtij avanci. Kjo është në kundërshtim me nenin 8 të U A nr. MSHP 2004/7 për udhëtime zyrtare, ku brenda 15 ditësh nga përfundimi i udhëtimit zyrtar duhet të bëhet mbyllja e avancit.

Konkluzioni:

Kuvendi i Kosovës nuk ka kontrole të mjaftueshme mbi dhënien, shfrytëzimin dhe menaxhimin efektiv të avancave, mënyrën e kthimit dhe arsyetimin e tyre.

Rekomandim 6:

Rekomandojmë Sekretarin permanent të Kuvendit të Kosovës :

- Të siguroj që arsyetimi dhe mbyllja e avancave të bëhet brenda afatit të përcaktuar sipas Udhëzimit Administrative nr. MSHP 2004/07 për udhëtime zyrtare.

3.5 Menaxhimi i pasurisë

Të gjitha organizatat buxhetore të financuara nga BKK janë të obliguara të veprojnë në pajtim me Udhëzimin Administrativ, nr. 2005/11 mbi menaxhimin dhe regjistrimin e pasurive qeveritare. Kuvendi i Kosovës nuk e ka respektuar në tërësi udhëzimin administrativ lidhur me pasuritë e blera dhe nuk ka kryer regjistrimet e nevojshme në regjistrin kontabël dhe regjistrin e pasurive..

Në praktikë të gjitha pasurit me vlerë monetare mbi 1,000 € dhe me jete të përdorimit më të gjatë se një vit duhet të regjistrohen dhe harmonizohen si në regjistrin e pasurive e po ashtu edhe në regjistrat kontabël (Thesar), ndërsa pasurit me vlere më të vogël se 1,000 € duhet vetëm të regjistrohen në regjistrin e pasurive të entitetit. Me rastin e rishikimit kemi gjetur se regjistrimet e disa pasurive nuk janë bërë.

Gjate krahasimit të modulit të librit të përgjithshëm (shpenzimet) me regjistrin kontabël kemi hasur që nuk janë regjistruar të gjitha pasuritë kapitale për vitin 2008.

Investimet kapitale të kryera gjate vitit 2008, e që nuk janë regjistruar në regjistrin kontabël janë:

- Trafostacioni për energji elektrike në vlerë prej 98,379 € me nr. të faturës 23/2008;
- Renovimi i restorantit të Kuvendit të Republikës së Kosovës në vlerë prej 19,293 € dhe nr. të faturës 09/2008.
- Fasada strukturale (ndërrimi i xhamave) në vlerë prej 19,550 € dhe nr. të faturës 1/08;
- Renovimi i kulmit dhe terasës së ndërtesës së Kuvendit në vlere totale prej 139,900 € dhe nr. e faturave: 390/08 me vlere prej 27,980 €; 461/08 në vlerë prej 41,970 €; 531/08 në vlerë prej 41,970 € dhe fatura me nr. 532/08 në vlerë prej 27,980 €.

Mos regjistrimi i disa pasurive jo kapitale në regjistrin e kontabël

1. Pajisje për sistem elektronik, video, projektor me vlere totale prej 9,953 € me nr. te faturës: 211;
2. Pajisje tjera me vlere prej 4,945 € me nr. te faturës: 08/2008.
3. Pajisje tjera-radiolidhje ne vlere prej 3,669 € me nr. te faturës:100408-191;
4. Pajisje tjera ne vlere prej 3,899 € me nr. te faturës:08-3531.
5. Pajisje për audio incizim ne vlere prej 5,023 € me nr. te faturës:2007290.

Kjo nuk është ne përputhje me nenin 15 te Instruksionit Administrativ 2005/11.

Konkluzioni

Kuvendi i Kosovës nuk posedon një regjistër definitiv mbi pasuritë në posedim. Mos regjistrimi dhe mos menaxhimi i duhur me pasurinë kapitale dhe jokapitale rrit rrezikun për keqpërdorimin dhe përvetësimin e kësaj pasurie.

Mos regjistrimi i pasurisë në regjistrin e pasurisë dhe regjistrin kontabël ndikon ne vërtetësinë dhe saktësinë e pasqyrave financiare.

Rekomandimi 7:

Rekomandojmë Sekretarin permanent të Kuvendit të Kosovës :

- Të sigurohet që të gjitha pasuritë mbi 1,000 € te regjistrohen ne regjistrin kontabël të Thesarit në përputhje me Instruksionin Administrativ 2005/11.

3.6 Sistemi i kontrollit të brendshëm dhe auditimi i brendshëm

Një sistem efikas i kontrollës së brendshme do të ndihmojë organizatatave për të arritur objektivat e tyre kryesore dhe për të kryer aktivitetet në mënyrë të kënaqshme e cila përfshin filozofinë dhe mënyrën e udhëheqjes të punës nga ana e menaxhmentit, ndarja e përgjegjësisë, mbikëqyrja dhe udhëheqja e sistemit dhe procedurat e kontrollës së brendshme

Nga paraqitjet e mësipërme dhe vëzhgimet tona për mënyrën e funksionimit të kontrollës së brendshme ka disa dobësi të cilat i paraqesim në vijim:

- Në procedurat e prokurimit
- Në paraqitjen e obligimeve
- Në mosparaqitjen e pasurive kapitale dhe mos vlerësimi i tyre

Të gjeturat:

- Në bazë të gjetjeve të elaboruara me lartë konkludojmë se sistemi i kontrollit të brendshëm nuk është tërësisht funksional dhe përcjellët nga disa dobësi të cilat menaxhmenti i Kuvendit të Kosovës duhet të marrë veprime konkrete në zvogëlimin e tyre. Dobësitë e shfaqura të kontrollit të brendshëm janë përshkruar nga gjetjet e paraqitura më lart.
- Gjatë vitit 2008 në Kuvendin e Kosovës ka funksionuar auditimi i brendshëm, dhe nga intervistat e kryera dhe dëshmitë e ofruara ka rezultuar se auditori i brendshëm ka bërë planifikimin e auditimit për vitin 2008 dhe nga ky planifikim ka kryer katër auditime dhe një auditim sipas kërkesës nga menaxhmenti i Kuvendi i Kosovës, për të cilat janë paraqitur raporte të veçanta të auditimit.

Konkluzion

Kontrolli i brendshëm akoma përcillet nga disa dobësi në funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, veçanërisht tek menaxhimi i pasurive. Auditimi i brendshëm edhe më tutje nuk mund të ofroj menaxhmentit një siguri të arsyeshme se kontrollet e brendshme funksionojnë në mënyrë të duhur.

Rekomandim 8:

Rekomandojmë Sekretarin permanent të Kuvendit të Kosovës :

Për të ndihmuar në përmirësimin e efikasitetit të kontrolleve të brendshme dhe funksionalizimin e auditimit të brendshëm rekomandojmë menaxhmentin e Kuvendit të Kosovës që:

- 8.1 Auditori i brendshëm të planifikoj në baza vjetore punën e tij në pajtim me nivelin e rrezikut të mundshëm që shoqëron aktivitetet e përditshme të Kuvendit. Kjo duhet të bëhet duke caktuar prioritetet në përmirësimin e proceseve të menaxhimit dhe parandalimin/zbulimin e gabimeve dhe mashtrimeve të mundshme.

Shtojca 1

Llojet e ndryshme të Opinioneve të Auditimit të zbatuara nga ana e ZAP në Raportet Vjetore të Auditimit për vitin 2009

(e shkëputur nga ISSAI 400)

9. Një opinion i auditimit normalisht është në format standard, ndërlidhur me pasqyrat financiare si tërësi, duke shmangur nevojën për caktuar gjatësinë e saj por duke bartur sipas natyrës së saj një kuptim të përgjithshëm tek lexuesit sipas kuptimit të saj.

Natyra e këtyre fjalëve do të ndikohet nga korniza ligjore të auditimit, por përbërja e opinionit duhet të tregoj qartë a është i pakualifikuar apo i kualifikuar, apo nëse është i kualifikuar në disa çështje të caktuara apo është opinion i kundërt (paragrafi 14), apo është mohim i opinionit (paragrafi 15).

10. Një opinion i pakualifikuar jepet kur auditori është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale që:

(a) pasqyrat financiare janë përgatitur duke shfrytëzuar baza dhe politika të pranuar të kontabilitetit të cilat janë zbatuar në mënyrë konsistence (të qëndrueshme);

(b) pasqyrat janë në pajtim me kërkesat statusore dhe rregulloret relevante;

(c) pamja e paraqitur në pasqyrat financiare janë përputhje me njohuritë e auditorit në lidhje me entitetin e audituar; i

(d) është një shpalosje adekuate e të gjitha çështjeve materiale relevante për pasqyrat financiare.

11. Theksi i çështjeve. Në disa rrethana auditori mundet të konsideroj se lexuesi nuk do të kuptoj në mënyrë të duhur pasqyrat financiare nëse vëmendja është përqendruar në çështje të pazakonshme apo të rëndësishme. Si një rregull e përgjithshme, auditori kur jep një opinion të pakualifikuar kjo nuk i referohet ndonjë aspekti specifik të pasqyrave financiare në opinionin e tij në rast se kjo mund të interpretohet gabimisht si opinion i kualifikuar. Me qëllim të shmangies së kësaj përshtypjeje, referencat që janë menduar si ;nënvizim i çështjes; gjinden në paragrafët e ndara nga opinionit. Sidoqoftë, auditori nuk duhet të përdor nënvizimin e çështjes për të përmirësuar mungesën e shpalosjeve të duhura në pasqyrat financiare apo si alternativ, zëvendësim për kualifikim të opinionit.

12. Auditori mund të mos jetë në gjendje të shpreh një opinion jo të kualifikuar kur ekziston një nga ato rrethana dhe në gjykimin e auditorëve, efektin e tyre është ose mund të jetë materiale për pasqyrat financiare:

(a) ka patur limitime në fushëveprimin e auditimit

(b) Auditori konsideron që pasqyrat janë jo complete apo çorientues apo ekziston një ndarje e pajustificuar nga standardet e pranueshme të kontabilitetit; apo (c) Ekzistojnë paqartësi që ndikojnë në pasqyrat financiare.

13. Opinioni i Kualifikuar. Aty ku auditori nuk pajtohet apo nuk është i sigurt në lidhje me një ose me tepër artikuj të veçantë në pasqyrat financiare e që janë materiale por jo edhe fundamentale në kuptimin e pasqyrave, duhet të jepet një opinion i kualifikuar. Formulimi i opinionit normalisht tregon një rezultat të kënaqshëm ndaj subjektit të audituar, sa i përket një pasqyre të qartë dhe koncize, të çështjeve të mospajtit apo edhe të paqartësive që ngrisin opinion e kualifikuar.

I ndihmon përdoruesit e pasqyrave nëse efekti financiar i paqartësisë apo edhe i mosmarrëveshjeve është përcaktuar nga ana e Auditorit edhe pse kjo nuk është gjithmonë praktike apo relevante.

14. Opinioni i Kundërt. Aty ku Auditori nuk ka mundësi të jap një opinion mbi pasqyrat financiare në tërësi, për shkak të mosmarrëveshjeve që është aq thelbësore ngase e minon pozitën e prezantuar në vazhdim që opinionin që kualifikohet në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, atëherë jepet opinionin i Kundërt. Formulimi i një opinionin të tillë e bën të qartë se pasqyrat financiare nuk janë prezantuar në mënyrë të drejtë, duke specifikuar qartë dhe në mënyrë koncize të gjitha çështjet e mosmarrëveshjeve. Përsëri, është një ndihmesë që efekti financiar mbi pasqyrat financiare përcaktohet aty ku duhet dhe është praktik.

15. Mohimi i Opinionit. Aty ku Auditori nuk mund të jep opinion në lidhje me pasqyrat financiare, të marrë si tërësi për shkak të paqartësisë apo restriksione të fushëveprimit që është thelbësor që një opinion që është i kualifikuar në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, jepet opinionin i kundërt. Formulimi i një opinionin të tillë të kundërt a bën të qartë që një opinion nuk mund të jepet, duke specifikuar në mënyrë të qartë dhe koncize të gjitha çështjet e paqarta.

16. Është bërë zakon që ILA të ofrojnë një raport të detajuar për të plotësuar opinionin në rrethana në të cilat është e pamundur të jepet një opinion jo i kualifikuar

Shtojca II: Komentet e Kuvendit të Kosovës dhe përgjigja e ZAP-it

Komentet e Kuvendit të Republikës së Kosovës	Përgjigjet e ZAP-it
<p>Komenti nr.1 Sa i përket realizimit të buxhetit në të gjitha kategoritë ekonomike kemi një realizim të kënaqshëm përveç të Investimet Kapitale ku na mungon një vendim i organeve kompetente për projektin Villa Germia</p>	<p>Mbesin konstatimet në raport Edhe nga komenti i paraqitur në kemi potencuar që investimet kapitale nuk janë shfrytëzuar në baze të planifikimit të kryer.</p>
<p>Komenti nr. 2 Në pasqyrat Financiare janë paraqitur të gjitha pasuritë të cilat kanë qene të regjistruara, të gjitha obligimet e vitit 2008 i kemi paraqitur në Pasqyra, të gjitha faturat që kanë date të vitit aktual ato nuk janë obligime të vitit paraprak sepse në sektorin publik punohet në baze të planit të rrjedhës së parëse e jo në baza akruale, Pasqyrat janë përgatitur në harmoni të plote me UA 2008/13 dhe si baze për përgatitje të tyre janë marre barazimi i Kuvendit me Thesarin</p>	<p>Mbesin konstatimet në raport përveç pasurive nën 1000 € Në e vlerësojmë sqarimet tuaja dhe dëshmitë e ofruara. Gjate auditimit nuk na është ofruar kjo liste e regjistrimit të pasurisë nën 1000 €. megjithatë dëshmitë e ofruara i marrim në konsideratë për ta ndryshuar konkluzionin tonë auditues. Në kemi potencuar që obligimet në vitin 2008 nuk janë prezantuar në PF, si obligime për vitin 2009, përveç vlerës 3,334 € si shpenzime të rrymës elektrike që e zvogëlon vlerën e përgjithshme të obligimeve nga 17,397 € në vlerën 14,063 €.</p>
<p>Komenti nr.3 Në mungese të udhëheqësit të shërbimit, në muajin gusht është angazhuar zyrtari i prokurimit për kohe të caktuar. Tani kjo geshkje është zgjidhur. Përndryshe, rekrutimi në Administratën e Kuvendit bëhet konform procedurave të parapara me Urdhëresën e cekur.</p>	<p>Mbesin konstatimet në raport Komenti i ofruar nga Kuvendi i Republikës Kosovës nuk ofron dëshmi bindëse për ta ndryshuar pohimin tonë. Konstatimi dhe rekomandimi i ZAP mbetet i njëjte.</p>
<p>Komenti nr.4 Plani përfundimtar është hartuar për 2008 por ka mbetur pa u finalizuar dhe dorëzuar në APP, për shkak të largimit të menaxherit të prokurimit cihë keqesimit të gjendjes shëndetësore të zyrtares tjetër të prokurimit. Zyra e Prokurimit ka praktikuar fillimin e çdo aktiviteti të prokurimit me kërkesë dhe me zotimin e mjeteve në sistemin e Free Bilancit. Mirëpo në tri rastet e apostrofuara nuk kemi arritur të plotësojmë, Deklarata e Nevojave dhe përcaktimit të disponueshmërisë së fondeve. Në të ardhmen në tërësi do veprojmë konform dispozitave gjegjëse të Ligjit të Prokurimit. - Praktika jone ka qene njoftimi i operatoreve ekonomik në mënyre</p>	<p>Mbesin konstatimet në raport Komenti i ofruar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës nuk ka ofruar dëshmi të mjaftueshme për ta ndryshuar pohimin tonë, prandaj KRK-ja ka bere vetëm arsyeshmërinë e të gjeturës, e jo dëshmi të ofruar për konkludimin dhe rekomandimin tonë të paraqitur në raport</p>

<p>elektronike por për shkak te angazhimeve te shumta na është here ky leshim. Ne te ardhmen operatoret ekonomik do te njoftohen dhe ato do arkivohen ne dosje.</p> <p>Ne kërkesë janë specifikacionet e plota dhe me kerkese dhe zotim te mjeteve te nënshkruar nga njësia kërkuese dhe nga autorizuesi,fillojhet aktiviteti i prokurimit, me qe rast edhe urdherblerja hartohet me përshkrim te shkurt dhe me kode ekonomike.</p> <p>Ne rastin e caktuar (furnizim me llaptop)pagesa është bere pas nënshkrimit te pranimit te mallit. Malli nga operatori ekonomik i sjelle me kohe, nuk është pranuar për shkak te nje gabimi nga prodhuesi, me c;rast kemi insistuar qe gabimi ne fjale te evitohet dhe pastaj te pranohet malli.</p>	
<p>Komenti nr.5 Janë ndërmarre masa qe shpenzimi i reprezentacionit do te jete plotësisht i menaxhuar. Tejkalimet e konstatuara do te mbulohen sipas rregullores.</p>	<p>Mbesin konstatimet ne raport</p> <p>KRK-ja është pajtuar me të gjeturën e paraqitur ne raport.</p>
<p>Komenti nr.6 Te gjitha avanset janë mbyllur me kohe përveç një avansi i cili ka qene me rimbursim nga Parlamenti Evropian. Jemi duke përgatitur një marrëveshje me PA ne mënyre qe te mos na paraqiten këto probleme ne te ardhmen</p>	<p>Mbesin konstatimet ne raport</p> <p>KRK-ja është pajtuar me të gjeturën e paraqitur ne raport,</p>
<p>Komenti nr. 7 Te gjitha pasurite si ato mbi 1,000€ ashtu edhe ato nen 1,000€ te cilat jane konstatuar nga Auditori se nuk jane regjistruar ne regjistra ne nderkohe jane regjistruar.</p>	<p>Mbesin konstatimet ne raport përveç pasurive nën 1000 €</p> <p>Dëshmitë e ofruara korrespondojnë me regjistër te pasurive nen 1000 € te cilën e kemi pranuar, nuk na keni ofruar dëshmi bindëse për pasurit mbi 1000 € qe janë te regjistruara ne regjistrin kontabël, Kemi kënaqësinë të pranojmë informimin tuaj me fillimin e implementimit të këtij rekomandimi. qe jep një dëshmi të fortë të gatishmërisë së menaxhmentit të Kuvendit te Kosovës për të ndërmarr masa për implementimin e tyre.</p>
<p>Komenti nr. 8 Aktivitetet e auditimit te brendshëm ne' Kuvendin e Kosovës kryhen ne pajtueshmëri me ligjin e auditimit te brendshëm dhe standardet profesionale për kryerjen e auditimit te brendshëm, te vendosura nga NjQH-ja, si dhe ne</p>	<p>Mbesin konstatimet në raport përveç themelimit të komisionit të auditimit.</p> <p>Dëshmitë e ofruara për themelimin e komisionit te auditimit i marrim përbase, shpresojmë qe auditori i brendshëm duke aplikuar një plan adekuat dhe cilësor do</p>

<p>pajtim me parimet e sjelljes te Kodit te Etikes. Auditimi I brendshëm është një veprim pasues "eks-post" qe për mes këshillave dhe rekomandimeve te veta e ndihmon menaxhmentin për te arritur objektivat, rregullat dhe standardet</p> <p>Me qellim te mbarëvajtjes se punës, menaxhimit te rrezikut dhe bashkëpunimit te AB me Njësite tjera brenda Kuvendit si dhe duke u nisur nga fakti qe auditori i brendshëm,mund te ofroj keshilla dhe shërbime te tjera konsultuese, gjate vitit 2008, jane organizuar takime te rregullta javore. Pjese e ketyre takimeve kane qene auditorja e brendshme dhe te gjithë personat kyq te kontrollit te brendshëm. Per te gjitha keto takime janë mbajtur procesverbale</p> <p>Keto takime, rekomandimet dhëna ne auditimet e kryera si dhe konsultimet e dhena sipas kërkesës, kane ndihmuar qe te evitohen disa parregullsi dhe paqartësi.. Plani vjetor është përgatite,ne baze te vlerësimit te rrezikut, prezanton objektivat afat-shkurtër te auditimit te brendshëm qe dalin nga Plani strategjik 2008-2010. Per te gjitha aktivitetet e auditimit te brendshëm ekzistojnë dëshmi te shkruara te cilat kemi qene te gatshëm te ofrojmë Ekipit nga Zyra e Auditorit te Përgjithshëm ne çdo moment nëse do te kërkohej.</p> <p>Komisioni për Auditimin e brendshëm është formuar, është siguruar dhe do te sigurohet edhe ne te ardhme pavarësi për funksionimin e auditorit.</p>	<p>te ndihmoj ne forcimin e kontrollit te brendshëm.</p>